



# SIGURIA KUNDËR ZJARRIT NË SHTËPI



Norsk  
brannvernforening


[brannvernforeningen.no](http://brannvernforeningen.no)

# DETEKTORËT E DETYRUESHËM TË TYMIT



Çdo shtëpi duhet të ketë të paktën një detektor tymi në secilin kat. Detektorët e tymit paralajmërojnë herët në rast zjarri. Alarmin duhet të arrini ta dëgjoni nga brenda dhomave të gjumit me dyer mbyllura. Bateritë normalisht duhet të ndërrohen një herë në vit. Testojini alarmet e tymit rregullisht duke shtypur butonin e testimit.

# PAJISJET E DETYRUESHME PËR FIKJEN E ZJARRIT



Çdo shtëpi duhet të ketë një zorrë uji kundër zjarrit ose një fikës zjarri. Rekomandohet që t'i keni të dyja. Pajisjet për fikjen e zjarrit duhet të arrihen lehtë. Të gjithë ata që jetojnë në pronë duhet të dinë se ku ndodhen këto pajisje. Lexojini me kujdes udhëzimet e përdorimit.

# PARANDALIMI I ZJARRIT 1




Mbajeni nën monitorim sobën e gatimit kur është në përdorim. Nëse ju ndërpritet gatimi, i fikni të gjitha vatrat në sobën e gatimit. Instaloni një alarm sobe/pajisje për mbyllje automatike. Kini kujdes kur përdorni flakët e hapura. Asnjëherë mos u largoni nga një dhomë me qiri të ndezur brenda. Qirinjtë e ndezur nuk duhet të vendosen pranë lëndëve të ndezshme. Zbrazeni hirin në një vend të sigurt. Mos e hidhni hirin e nxehtë në koshin e plehrave.

# PARANDALIMI I ZJARRIT 2



Gjithmonë mbylleni lavatriçen dhe tharësen kur dilni nga shtëpia apo kur shkoni për të fjetur. Vetëm elektrikistët e kualifikuar lejohen t'i instalojnë dhe riparojnë pajisjet dhe instalimet elektrike. Lëndët e ndërtimit, kutitë prej kartoni dhe mbetjet e tjera që lihen rrotull përdoren shpesh për zjarret e qëllimta. Sigurohuni që shkallaret dhe garazhet të mos kenë artikuj të ndezshëm. Vendosini kazanët e plehrave larg nga ndërtesat.

# ÇFARË DUHET BËRË NË RAST ZJARRI



## 1) SHPËTONI

Sigurohuni që të gjithë të dalin jashtë shëndoshë e mirë. Largimi përmes tymit është i rrezikshëm. Mbyllni dyert. Shkoni te një pikë takimi që e keni caktuar më parë.

## 2) NJOFTONI

Njoftoni shërbimin zjarrfikës duke telefonuar numrin e urgjencës 110. Tregoni adresën e saktë të ndërtesës që po digjet.

## 3) FIKENI

Nëse zjarri nuk është bërë tepër i madh, provoni ta fikni me zorrën e ujit ose fikësin e zjarrit. Mos e vini veten në rrezik. Tymi është tepër toksik.

Vlerësimi që i bëni ju situatës do të përcaktojë rendin sipas të cilit do të kryeni këto hapa. Është mirë të kryeni rregullisht stërvitje për zjarret, në mënyrë që të gjithë të praktikojnë çfarë duhet bërë.



Kjo broshurë disponohet në 30 gjuhë të ndryshme nga uebsajti i Shoqatës Norvegjeze të Mbrojtjes nga Zjarri:  
[www.brannvernforeningen.no/brannsikker](http://www.brannvernforeningen.no/brannsikker)